



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:220989  
Datë: 12.02.2024  
Numri i dokumentit: 05317262

**C.nr.1488/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në kontestin e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. KEDS – Distrikti në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson juristja G.H. nga Prizreni, kundër të paditurit M.Sh. me numër personal .... me vendbanim në Prizren, me objekt të padisë kompensim dëmi material, vlera e kontestit 2,731.97 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencë të përfaqësueses së paditëses dhe të paditurit, me datën 22.01.2024 mori, ndërsa me datë 12.02.2024 përpiloj me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A - KEDS – Distrikti në Prizren, **DETYROHET** i padituri M.Sh. nga Prizreni, që paditëses t'ia kompensoj shumë prej nëntëqindeshtatëdhjetepesë euro e nëntëdhjetepesë cent (975.95 €), dhe atë në emër të kompensimit të dëmit material – rikthimit të humbjeve, me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur prej ditës së parashtrimit të padisë (03.10.2019), e deri te pagesa definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**II. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. KEDS – Distrikti në Prizren përtej vlerës së aprovuar si në pikën nën I të dispozitivit, dhe atë kërkesa në lartësi prej njëmijeshtatëqindesëdhjetegjashtë euro e dy cent (1,756.02 €).

**III. DETYROHET** i padituri M.Sh. nga Prizreni, që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej dyzet euro (40.00 €), në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### **1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. KEDS – Distrikti në Prizren, me datë 03.10.2019, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit M.Sh. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 2,731.97 euro. Ka shtuar se këtu i padituri sipas aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Prizren me shenjë P.nr. 2382/17, të datës 22.11.2018, i plotfuqishëm nga data 02.01.2019 është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 320 KPK-së, me ç' rast paditëses në fjalë i ka shkaktuar dëm material. Paditësja i është drejtuar kësaj gjykate, nga e cila ka kërkuar që kërkesëpadinë e saj ta aprovojë në tërësi si të bazuar duke e obliguar të paditurin që të paguaj vlerën e pretenduar të dëmit të shkaktuar apo shumën prej 2,731.97€, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e autorizuara e paditëses G.H. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës e të administruara në shqyrtim kryesor vërtetohet saktësisht dëmi që i shkaktuar paditëses, dhe atë sipas aktgjykimit të GJTH në Prizren me shenjë P.nr.2382/17 të datës 22.11.2017, ku i padituri e ka pranuar fajësinë për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 320 KPK-së, duke i shkaktuar dëm material paditëses në lartësi prej 2,731.97 euro, vlerë kjo e kalkuluar sipas procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Tutje ka shtuar se lidhur me ekspertizën e ekspertit të elektroteknikës, mbesin pranë vërejtjeve të paraqitura me shkrim dhe atyre në seancës, për shkak se fakti i kalkulimit të rikthimit të humbjeve është dashur të bëhet në bazë të veprimtarisë komerciale 7/02, duke u bazuar në pajisjet të cilat janë hasur në objekt në momentin e konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike. Në fund i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, në shumë prej 40 euro, në emër të taksës gjyqësore për padinë e parashtruar.

Përmes përgjigjes në padi i padituri e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, përkundër faktit se me aktgjykimin P.nr.3282/17 të datës 22.11.2019 është shpaluar fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, për shkak të pranimit të fajësisë. Ka shtuar se e pranon faktin se ditën kritike ka ekzistuar lidhja direkte, vetëm për provë tek shtëpiza që është ndërtuar nga djali i axhës, dhe se në procedurë administrative pranë të paditurës e ka kundërshtuar faturën DPZ17HP12276 të datës 30.09.2017, e cila është llogaritur për 12 muaj, e cila kërkesë i është refuzuar nga e paditura si e pabazuar. Tutje ka theksuar se leximi i njehsorit elektrik nga ana e zyrtareve të paditëses është bërë për çdo muaj, dhe asnjëherë nuk është hasur në parregullsi siç pretendon paditësja, e me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike ka propozuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së elektroteknikës.

Edhe gjatë shqyrtimit kryesor i padituri kishte deklaruar se ka mbetur në tërësi sikurse në përgjigje në padi duke shtuar se nuk është kontestuese fakti se është shpallur fajtor në procedurën penale për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga nenin 320 i KP-së, por kontestuese mbetet dëmi të cilën i ka shkaktuar paditëses dhe mënyra e llogaritje nga ana e paditëses. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara u vërtetuar fakti se dëmi i shkaktuar paditëses nuk është si në kërkesëpadi, duke i kërkuar Gjykatës që të njëjtën ta refuzoj mbi shumën e konstatuar nga eksperti i elektroteknikës.

## **2. Provat e administruara,**

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike, gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e këtyre provave: Ekspertizën e ekspertit të elektroteknikës të përpiluar nga ana e ing. M.Gj. nga Prizreni, të datës 14.12.2023, dhe deklarin e ekspertit në shqyrtimin kryesor të datës 22.01.2024; leximi i aktgjykimin penal me shenjën P.nr.3282/17 i datës 22.11.2018; fatura e rikthimit të humbjeve me nr. DPZ 17HP12276 e datës 30.09.2018.

Nga leximi i ekspertizës së ekspertit të elektroteknikës M.Gj. ing. i dipl. i elekt, të datës 14.12.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se në bazë të kalkulimit të shpenzimeve të energjisë elektrike, bazuar në shkresat e lëndës dhe dokumentacionin e bashkangjitur nga paditësja, e veçenarshtë në dokumentacionin e nënshkruar dhe pranuar nga i padituri ditën e kontrollit, shikimit në vend nga ana e ekspertit, është konstatuar se për rikthim të humbjeve të energjisë elektrike pala e paditur ka obligim shumën prej 975.95 euro. Kjo llogaritje e shpenzimeve është bërë për pajisjet të cilat janë konstatuar nga ekipa e paditëses në procesverbalin e kontrollit sipas veprimtarisë- grupit tarifor 4/02 që aplikohet për amvisëri, për faktin se në momentin e kontrolles i padituri i ka takuar këtij grupi tarifor, e jo sipas faturës për kalkulimin të energjisë elektrike e datës 30.09.2017 të bërë nga paditësja për grupin tarifor 7/02, pasi që i padituri nuk i ka taku këtij grupi. Tutje ka theksuar se mendimin e tij e ka bazuar në nenin 13 të procedurave për identifikimin dhe parandalimin të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ku parashihet se llogaritja për rikthimin e humbjeve tek konsumatorë familjar është 6 muaj, e bazuar në fuqinë e shpenzimeve prej 2205 kw në muaj del shuma prej 150.61 euro në muaj, e nëse këtë e shumëzojmë për 6 muaj, fatura e rikthimit të humbjeve në rastin konkret del se është 975.95 euro me TVSh prej 08%.

Gjykata, në shqyrtimin kryesor të datës 22.01.2024, ka bërë dëgjimin e ekspertit, i cila ka qëndruar në tersi pranë ekspertizës, duke theksuar se pas analizës së dokumentacionit të lëndë dhe pas vizitës së objektit kam ardhur në përfundim se objekti në fjalë përdoret për rruajtje të bagëtisë është jashtë qytetit të Prizrenit në afërsi 2 deri 3 km, dhe sipas procesverbalit të datës 26.09.2017, me nr. 2420947 është konstatuar se konsumatori M.Sh.Sh. ka shfrytëzuar energjinë elektrike jashtë njëisorit matës me anë të ndërprerës që ka qenë i vendosur para njëisorit e kështu që një sasi e energjisë elektrike e harxhuar nuk është regjistruar në njëisor. Sipas procesverbalit të kontrollit të njëisorit si dhe në bazë të dokumentacionit të KEDS-it, deri më datën 26.09.2017 ky konsumator në KEDS ka qenë i regjistruar si konsumator i amvisërisë, gjegjësisht si veprimtari 4/02, pas konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike nga komisioni i KEDS i

cili ka konstatuar këtë shfrytëzim të pa autorizuar kërkohet dhe urdhërohet që grupi tarifor nga 4/02 të nderohet dhe të bartet në grupin tarifor 7/02. Fatura e rikthimit të humbjeve është bërë për periudhën para datës 26.09.2017, gjegjësisht në kohën kur konsumatori ka qenë në grupin tarifor 4/02, prandaj edhe llogaritja faturimi i rikthimit të humbjeve duhet të bëhet për periudhën kur konsumatori ka qenë në tarifën 4/02, prandaj unë kam korigjuar faturën për rikthimin e humbjeve duke llogaritur të gjitha pajisjet të cilat janë hasur në ditën kur është konstatuar shfrytëzimi i energjisë elektrike dhe duke llogaritur sipas procedurave të identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të energjisë elektrike për grupin tarifor 4/02. Ku energjia e kalkuluar për një muaj në bazë të llogaritjes është 2205 kw si dhe pas llogaritjes së energjisë për një muaj del se shpenzimet për rikthimin e humbjeve për një muaj janë 150.61 euro. Meqenëse në bazë të procedurave për identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të pa autorizuar për grupin tarifor 4/02, fatura e rikthimit të humbjeve llogaritet për 6 muaj prapa e që vlera e energjisë së kalkuluar të energjisë së rikthimit të humbjeve për 6 muaj 903.65 euro me Tvsh 8% del se fatura e rikthimit të humbjeve duhet të jetë 975.95 euro. Ndërsa në pyetjet e të autorizuarës së paditëses se, duke qenë se keni qenë në vizitë në vendin ku është bërë keqpërdorimi i energjisë elektrike objekti a ka qenë amvisëri apo objekt që është shfrytëzuar për veprimtari komerciale, eksperti ka deklaruar se një pjesë e objekti në fjalë tani shfrytëzohet për banim, një pjesë si stallë dhe një pjesë si depo për ushqim të bagëtive, ndërsa sa i përket pajisjeve të konstatuar në procesverbalin e kontrollit të njëjta më nuk gjenden në objekt dhe se për llogaritjen e kam bërë bazuar në procesverbalin e datës 26.09.2017, i nënshkrua edhe nga vetë i padituri që nënkupton se i njëjti e ka pranua faktin se ato pajisje kanë qenë në momentin e kontrollës, (më gjerësisht si në ekspertizën e datës 14.12.2023 dhe procesverbalin e datës 22.01.2024).

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, me shenjë P.nr. 2382/17 të datës 22.11.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri M.Sh. ishte shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 i KP-së, për lidhjen e paautorizuar në shërbime e kryer kundër furnizuesit të autorizuar KEDS, me ç ‘rast të njëjtit i kishte shqiptuar dënim me kusht (për më tepër sikurse në aktgjykimin në fjalë).

Nga leximi i faturës së konsumatorit me nr. DPZ17HP12276 të datës 30.09.2017, të lëshuar nga ana e paditëses, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura në procedurën e brendshme administrative duke zbatuar procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, kishte vlerësuar se rikthimi i humbjeve për energjinë e shpenzuar nga i padituri për shkak të lidhjes së paautorizuar, ishte 2,731.97 €.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra dhe të cekura si më lartë, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar**

**3). Baza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës,**

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestuese ishte lartësia e dëmit të shkaktuar, andaj në këtë drejtim gjykata e ka parë të nevojshme të merr prova të veçanta.

Me nenin 136 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, ndërsa neni 140 të po këtij ligji ka paraparë se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Po ashtu, neni 169 paragrafi 1 dhe 2 kanë paraparë se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*, përkatësisht *“Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”*. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se ***“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”***, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se *“Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me 3 kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)...”*.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovet pjesërisht e bazuar, apo si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Kjo ngase është provuar se i padituri në shtëpinë e tij e cila gjendet në rrugën “Besim Shala”, në periferi të Prizrenit, ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjisë elektrike dhe me këtë veprim i ka shkaktuar dëm paditëses. Kjo është vërtetuar në bazë të provave të administruara e sidomos, ku baza e kërkesëpadisë u vërtetuar nga aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore në Prizren me shenjen P.nr.2382/17 të datës 22.11.2018, i cili vendim është bërë i plotfuqishëm me datën 02.01.2019, me të cilin i padituri është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KP-së). Ndërsa sa i përket lartësisë së dëmit, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se vlera e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike nga ana e të paditurit është në shumën prej 975.95 euro. Deri te ky vlerësim gjykata erdhi duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit nga lëmia e elektros M.Gj. nga Prizreni, të cilit gjykata i fali besimin e plotë. Gjykata i fali besimin e plotë kësaj ekspertize për faktin se kalkulimi i tij është i bazuar në rregulloret e KEDS-it të aprovuara nga ZRRE, konkretisht nenet 32, 33 dhe neni 35, të Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, pastaj me nenin 15 të Rregullores për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike. Në këtë drejtim i padituri ka keqpërdorur energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar deri me dt. 26.09.2017 dhe përlllogaritja për rikthimin e humbjeve ka përfshirë strukturën tarifore të vitit 2017 (për periudhën 6 muaj) të aprovuar nga ZRRE duke e marrë çmimin më të lartë të grupit. Andaj, provave të lartcekura gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, andaj dhe kërkesëpadinë e paditëses e aprovoi pjesërisht të bazuar, si në pikën I të dispozitivit. Shumën e dëmit të konstatuar nga ana e ekspertit, e cila shumë është aprovuar edhe nga ana e kësaj gjykate, nuk

është kontestuar as nga vet i padituri, andaj gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj i padituri për shumën e aprovuar për dëmin material, me kamatë prej 8%, krejt kjo duke u bazuar në nenin 382 parag. 1 dhe 2 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me nr.265/2020, të datës 02.12.2020, pjesa e tretë pika XIV, dhe atë të njëjtën e ka llogaritur nga data e parashtrimit të padisë (datë 03.10.2019).

Pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses përtej shumës së aprovuar, dhe atë kërkesa deri në shumën prej 1,756.02 euro, gjykata e refuzoi, ngase gjeti se e njëjta është e pabazuar. Kjo ngase në bazë të provave të administruara, e sidomos nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të elektroteknikës (i bazuar në provat e ofruar nga vetë e paditura), është konstatuar se dëmi të cilin i padituri ia ka shkaktuar paditëses është në lartësinë prej 975.95 euro, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit.

Lidhur me pretendimet e palës paditëse se eksperti i elektroteknikës, gabimisht e ka aplikuar grupin tariforë 4/02 i cili zbatohet për ekonomitë familjare me rastin e përpilimit të ekspertizë për rikthimin e humbjeve, pasi pajisjet të cilat janë evidentuar në procesverbal e datës 26.09.2017, janë pajisje që kanë përdorim për qëllime komerciale dhe nuk janë të destinuara për përdorim në amvisëri, dhe është dashur ta zbatoj nenin 15 të rregullore së ZRE-së, pasi kalkulimi i rikthimit të humbjeve është dashur të bëhet në bazë të veprimtarisë komerciale 7/02, gjykata një pretendim të tillë e gjeti si të pa bazuar dhe jo i mbështetura në provat të cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësorë. Gjykata e gjeti si të drejtë konstatimin e ekspertit të elektroteknikës lidhur zbatimin e grupit tariforë 4/02 me rastin e kalkulimit të rikthimit të humbjeve për pajisjet e evidentuara në procesverbalin e nënshkruar nga vetë i padituri, kjo duke marrë parasysh faktin se vetë paditësja të paditurin e ka kategorizuar në grupin tariforë 4/02, dhe se me rastin e faturimit të faturave mujore nga ana e punonjësve të saj nuk është ndërmarrë asnjë veprim apo procedurë administrative për ndërrimin e grupit tariforë deri me datë 26.09.2017.

Gjykata, në shqyrtimin kryesor të datës 22.01.2024, e ka refuzuar propozimin e palës paditëse për kthimin në plotësim të ekspertizës së elektroteknikës së datës 14.12.2023, pasi që gjykata vlerësoi se ekspertiza e cekur më lartë e punuar nga eksperti ing. M.Gj. nga Prizreni është e plotë dhe e punuar në mënyrë profesionale të cilës gjykata i'a fali besimin e plotë, lidhur me vlerësimin e lartësisë së dëmit. E paditura me asnjë provë nuk e provoj faktin se i padituri në objektin në të cilën është hasur keqpërdorimi i energjisë elektrike, ka zhvilluar veprimtari komerciale apo profesionale, e bazuar në procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike e miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji me vendimin V\_203\_2009 të datës 23 korrik 2009, kalkulimi i rikthimit të humbjeve duhet ti ishte bërë sipas grupin tarifor 7/02, bazuar në nenin 15 të kësaj rregullore. Përkundrazi nga provat e dorëzuar nga vetë paditësja, u vërtetuar fakti se deri me datë 26.09.2017, i padituri i ka takuar grupit tariforë 4/02, dhe faturimi i energjisë elektrike i ishte bërë sipas këtij grupi tarifor, e nga konstatimi i këtij fakti u desh të refuzohet propozimi i paditëses për kthimin në plotësim të kësaj

ekspertize. Gjithashtu në kuptim të nenit 7 të LPK-së dhe në lidhje me nenin 319 pika 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Për pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452.1 dhe 453.2 të LPK-së.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:220989, 12.02.2024**

**Gjyqtari**

---

**Baki Shigjeqi**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.